



Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

07 Nr. 320-5625/22

Klinë, me 23, 02, 2022

Projekti komunal për përkrahjen në zhvillimin e blegtorisë (furnizim me makina mjelëse për lopë, dele dhe dhi).

Në kuadër të zhvillimit dhe përparimit të bujqësisë- Komuna e Klinës – Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me qëllim të përkrahjes dhe zhvillimit të sektorit të bujqësisë - blegtorisë, bën :

THIRRJE PUBLIKE

Fton fermerët e interesuar për të aplikuar në projektin furnizim me makina mjelëse për lopë, dele dhe dhi.

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në këtë projekt do të kontribuoj :

- Me 70 % të kostos së makinës, ndërsa fermeri me 30 %; dhe
- Dhënien e këshillave profesionale, përmes eksperteve të saj.

Kriteret e konkurrimit:

1. Fermeri duhet të jetë banorë i Komunës së Klinës;
2. Të merret me kultivimin e Blegtorisë;
3. Të posedon së paku 2 krerë lopë qumështore apo 20 krerë dele apo dhi të mbarsura;
4. Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë përfutur asnjëherë nga projektet e Drejtorisë së Bujqësisë.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kërkesa e plotësuar nga fermeri, e cila merret në zyrën pritëse në hyrje të objektit të komunës;
2. Kopja e letërnjoftimi;
3. Certifikata e vendbanimit;
4. Kopja e certifikatës së NIF-it;
5. Vërtetimi mbi pronësinë e kafshëve, i lëshuar nga AVU-ki (veterinari);
6. Regjistri i kafshëve, i lëshuar nga AVU-ki (veterinari);
7. Vërtetimi i tatimit në pronë.

Afati i aplikimit, është nga data 24.02.2022 deri me dt. 07.03.2022. Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyrën pritëse në hyrje të objektit të komunës.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Vërejtje: Nëse të dhënat e deklaruara në kërkesën për aplikim nuk përputhen, me gjendjen faktike të vërtetuar në teren nga komisioni, aplikuesi do të sanksionohet me minues 10 pikë.

Drejtori i Drejtorisë së BPZH
Lorenc Marleku

